



Data: 21.05.2026

A.nr.2015/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2015/2025, të datës 11.12.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B nga Vushtrria, kundër organit të punësimit: Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.2015/2025, e datës 11.12.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.B.
- II. Obligohet** Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative, ashtu që, ankuesit t’i njihet e drejta në shtesë tranzitore sikurse është përcaktuar në arsyetimin këtij vendimi, përfshirë edhe kompensimin retroaktiv nga data 03.01.2025 e deri në zbatimin e këtij vendimi.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet lidhur me veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.B (*tutje referuar vetëm si: ankuesi*), më datë 11.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli Nr.62117/25, të datës 09.12.2025, të Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vushtrrisë, ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjën në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7821/2025, të datës 11.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës, të datës 11.12.2025; Përgjigje në kërkesë me numër protokolli Nr.62117/25, i datës 09.12.2025; Kopjen e letërnjoftimi të ankuesit; Akt emërimi me numër protokolli Nr.00018/25, i datës 03.01.2025; Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 28.10.2025; Kërkesë për pagesën e “shtesës tranzitore”, i datës 28.10.2025; Konkursi me numër reference RN00018911, i datës 23.10.2025; Konkursi me numër reference RN00018910, i datës 23.10.2025; Konkursi me numër reference RN00018924, i datës 28.10.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2025; Përgjigje në ankesë e datës 13.01.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Konkursi me numër reference RN00015213., i datës 20.09.2024; Përshkrimi i detyrave të vendeve të punës në Njësinë e Auditimit të Brendshëm; Klasifikimi i vendeve të punës; Lista e pagave për ankuesin dhe zyrtaret e njësish së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Vushtrrisë dhe Përgjigjja në kërkesë e datës 09.12.2025 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për ankuesin.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si ka gjetur së ankesa **është e bazuar, sepse:**

Vlerësimi i Gjendjes Faktike

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se:

- ankuesi me datë 03.01.2025, ka themeluar marrëdhënia pune me Komunën e Vushtrrisë, ashtu që, i njëjti sipas Akt emërimit me numër protokolli Nr.00018/25, të datës 03.01.2025, ushtron pozitën e punës *Auditor i Brendshëm*, në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, me koeficientin e pagës E15- 7.00.
- më datë 28.10.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, për njohje të shtesës tranzitore në kuadër të pagës mujore, duke kërkuar që pagesa e shtesës tranzitore të ekzekutohet retroaktivisht duke filluar nga data 03.01.2025.
- Komuna e Vushtrrisë më datë 09.12.2025, përmes Përgjigjes në kërkesë me numër protokolli Nr.62117/25, ka njoftuar ankuesin: *“Sa i përket kërkesës suaj për shtesë tranzitore, ju njoftoi se nuk kemi pasur të drejtë ligjore sepse katalogu, ligji i pagave dhe aktet tjera nuk parashohin shtesën tranzitore për të punësuarit pas hyrjes në fuqi të ligjit, por vetëm për zyrtarët të cilët kanë qenë të punësuar para hyrjes në fuqi të ligjit dhe akteve tjera”*.

Pretendimet Ankimore

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, duke kundërshtuar Përgjigjen e datës 09.12.2025, të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, më pretendimet së të njëjtit ti njihet e drejta e shtesës tranzitore, e drejtë kjo që sipas ankuesit bazohet në Aktgjykimin A.gj.2316/2024 të datës 24.01.2024, Ligjit Nr.08/L-196 për Paga në Sektorin Publik, nenin 24 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit Nr.12, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Propozon që KPMSHCK-ja të aprovoj ankesës si të bazuar, të detyroj Komunën e Vushtrrisë që të aplikoj shtesën tranzitore në pagën e tij mujore si dhe të bëj kompensimin retroaktiv të kësaj shtese, duke filluar nga data 03.01.2025.

Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, më theks të veçantë:

-Nenit 2, paragrafi 1, ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*

-Nenit 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozitë të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik''*

-Nenit 41 Shtesa tranzitore 1. *Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë. 2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të tij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përfshihet nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore.*

Rrjedhimisht, Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik i është nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila më Aktgjykimin AGJ 2316/24, 23 janar 2024, në rastin nr. KO79/23, ka vendosur se: *IV. TË KONSTATOJE se paragrafi 2 i nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; V. TË KONSTATOJE se paragrafi 3 i nenit 41 (shtesa tranzitore) të Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të kushtetutës ne ndërlidhej me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; VI. TË KONSTATOJE se paragrafi 4 i nenit 41 (shtesa tranzitore) të Ligjit nr. 08jL-196 për Pagat ne Sektorin Publik nuk është ne përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të kushtetutës ne ndërlidhje me nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; VII. TË SHPALLË të pavlefshëm paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (shtesa tranzitore) dhe paragrafin 2 të nenit 45 (Shfuqizimi) të Ligjit nr. 08jL-196 pre Pagat ne Sektorin Publik, nga hyrja ne fuqi e këtij Aktgjykimi;*

Konstatimin si më sipër, Gjykata Kushtetuese e kishte sqaruar sipas pikës 383 dhe 385, ashtu që, e njëjta ka përcaktuar se: 383: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlerëshme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind përqind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar*. “385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin e kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucionesh në Republikën e Kosovës... **Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.**

Andaj, referuar bazës ligjore dhe kushtetuese si më lart, Kolegji i Këshillit konstaton se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozitë të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Rrjedhimisht, sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik janë shpallur të pavlefshme, atëherë, e drejta në shtesë tranzitore sipas parafit 1 të nenit 41 do të aplikohet edhe në raport me zyrtarët që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të ligjit për pagat në sektorin publik. Rrjedhimisht, në kuptim të këtij përcaktimi rrjedhë së aplikimi i shtesës tranzitore duhet të zbatohen atë mënyrë që zyrtari/ja publik/e realizon koeficientin e pagës të përcaktuar për pozitën përkatës sipas shtojcës të Ligjit për pagat në sektorin publik duke shtuar shtesën tranzitore si diferencë e barabartë me diferencën ndërmjet pagës së vjetër dhe pagës së re bazë, ashtu që shtesa tranzitore do jetë efektive deri sa paga bazë e zyrtarit nevilizohet/barazvlerësohet me pagën bazë që zyrtari ka realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Thënë si lartë, Kolegji duke u bazuar në provat e lëndës ka gjetur së ankuesi është emëruara si Auditor i Brendshëm në Komunën e Vushtrrisë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, gjegjësisht më datë 03.01.2025, dhe së i njëjti është duke realizuar pagë sipas klasës së pagës E15- koeficient 7 (770 euro), ndërsa, zyrtari F. Shala i cili mbanë pozitë po të njëjtë në Komunën e Vushtrrisë para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka realizuara pagë më koeficient 15/1 apo 1.051.79 euro pagë bazë bruto, ndërsa, më hyrjen në fuqi të këtij ligji realizon pagë sipas klasës së pagës E15, koeficienti 7, dhe shtesën tranzitore duke ruajtur nivelin e pagës bazë që i njëjti e ka pas para hyrjes në fuqi të ligjit për pagat në sektorin publik, andaj, nisur nga këto rrethana dhe fakte, Kolegji erdhi në përfundimin së bazuar në parimin e trajtimit të bartë dhe mos diskriminimit dhe bazuar edhe në përcaktimet e Gjykata Kushtetuese sipas Aktgjykimit për rastin Nr.KO79/23, atëherë, ankuesit i njihet e drejta e realizmit të shtesës tranzitore në mënyrë të njëjtë sikurse zyrtarit F.G.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, konkretisht aprovoj ankesën si të bazuar, duke obliguar Kryetarin e Komunës dhe Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, që brenda afatit prej 15 ditsh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative, ashtu që, ankuesit t'i njihet e drejta në shtesë tranzitore përfshirë edhe kompensimin retroaktiv të kësaj shtesë nga data 03.01.2025 e deri në zbatimin e këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.2015/2025

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, A.B;
- Komunës së Vushtrrisë: Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.